

Nr. 441, datë 26.9.2002

**PËR NDALIMIN E MENJËHERSHËM TË VEPRIMTARISË SË SHFRYTËZIMIT TË
RËRËS DHE ZHAVORRIT NË SHTRETËRIT E LUMENJVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ndalimin e menjëhershëm të veprimtarisë së shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit në shtretërit e të gjithë lumenjve.

2. Çmontimin e të gjithë impianteve të thyerjes e të fraksionimit të zhavorrit që nxirret nga shtretërit e lumenjve deri më datë 31.12.2002.

3. Ministria e Industrisë dhe Energjetikës të shqyrtojë me përparësi kërkesat për pajisjen me leje shfrytëzimi të gurit gëlqeror të subjekteve, të cilave u ndalohet veprimtaria e shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit në shtretërit e lumenjve.

4. Ngarkohen Këshilli Kombëtar i Ujit, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministria e Industrisë dhe Energjetikës, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano